



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE E GJILANIT**  
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

---

**AD.GJTH.GJL.nr.23/24**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, përmes kryetarit të gjykatës Venhar Salihu, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, duke vepruar sipas ankesës së datës 29.11.2024 të parashtruar nga ankuesi B. P. nga Pasjani, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqarit S. B. – gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan, Departamenti për të Mitur, më datë 03.12.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZHET e pabazuar** ankesa e parashtruar nga ankuesi B. P. nga Pasjani, e datës 29.11.2024, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqarit S. B. – gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan, Departamenti për të Mitur, konform Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

**A r s y e t i m**

Më datë 29.11.2024, ankuesi B. P., përmes email zyrtar dhe përmes parashtresës më datë 02.12.2024 është ankuar për sjelljen e gjyqarit S. B. në seancën gjyqësore të datës 27.11.2024 për lëndën P.nr.665/23, duke theksuar se i njëjti ia ka ndaluar ankuesit të parashtrojë pyetje sugjестive ndaj një dëshmitari dhe duke i thënë me fjalët “a je ti normal” e pastaj “ku e ke kryer fakultetin”. Ka theksuar se këto nuk janë të përfshira në procesverbal, e shumë gjëra mungojnë në procesverbal, ndërsa ka konsideruar se shprehja “a je ti normal” nuk i përshtatet një gjyqtari, përkundër se në seancën e dytë gjyqësore, gjyqtari ka pasur qasje profesionale, mirëpo ka kërkuar që incidente të tilla si në seancën e parë gjyqësore të mos përsëriten më. Ka shtuar se nuk e ka nënshkruar procesverbalin, por vetëm faqen me emrat e të pranishmëve.

Pas shqyrtimit të ankesës, bazuar në nenin 9, paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, autoriteti kompetent konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar dhe nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore.

Pretendimet e ankuesit nuk konsistojnë në shkeljet disiplinore të parapara me këtë ligj, ashtu që nga shkresat e lëndës P.nr.665/23 konstatohet se procesverbali i datës 27.11.2024 për këtë çështje penale është nënshkruar pa vërejtje nga palët në proces. Lidhur me pretendimet e ankuesit se nuk i janë përshkruar në procesverbal ankesat e tij, kryetari i gjykatës vlerëson se gjyqtari i çështjes duke zbatuar kompetencat e tij të

ushtrimit të funksionit si gjyqtar, përshkruan në procesverbal të dhënat thelbësore lidhur me çështjen konkrete. Njëherit, ky procesverbal është nënshkruar pa vërejtje nga asnjë nga palët në proces. Prandaj, pretendimet e ankuesit nuk mund të paraqesin shkak për shkelje disiplinore të gjyqtarit S. B..

Kryetari i gjykatës vlerëson se kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore ndaj një gjyqtari bazohet në shkeljet disiplinore të cilat janë të rradhitura taksativisht në nenin 5 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ndërsa nga të theksuarat më lartë konstatohet se nuk mund të gjendet ndonjë sjellje e gjyqtarit S. B. që bie ndesh me ligjin. Gjithashtu, nga pretendimet e ankuesit nuk mund të konstatohet asnjë shkak tjetër që bie ndesh me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë.

Ankuesi në anën tjetër ka të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve juridike ligjore për të kundërshtuar një vendim që e konsideron jo të drejtë dhe të ligjshëm, ndërsa ankesa të tilla të paargumentuara nuk mund të prodhojnë efekt në procedurë disiplinore.

Andaj kryetari i kësaj gjykate, konform nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, ka gjetur se ankesa e parashtruesit B. P. nga Pasjani, e datës 29.11.2024, është e pabazuar dhe për të njejtën ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Kryetari i Gjykatës,  
Venhar Salihu**

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Vendimi duhet i dorëzohet:

1. Parashtruesit të ankesës,
2. Gjyqtarit S. B.,
3. KGJK-së,
4. Dosjës së lëndës.